



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria –Vlada-Government**  
**Ministria e Drejtësisë- Ministarstvo Pravde- Ministry of Justice**

---

**NJOFTIM**

**PËR KOHËN, VENDIN E MBAJTJES DHE PAGESEN PËR PROVIM TË JURISPRUDENCËS**

Njoftohen të gjithë kandidatët të cilët kanë aplikuar për dhënien e provimit të Jurisprudencës për afatin Maj 2023, se pjesa e Provimit të Jurisprudencës me shkrim do të mbahet me datat si në vijim:

**Lënda: E Drejta Penale do të mbahet me datë 13 Maj 2023 (e Shtune) me fillim në ora 10:00, provimi do të zgjasë 4 (katër) orë.**

**Lënda: E Drejta Civile do të mbahet me datë 14 Maj 2023 (e Diele ) me fillim në ora 10:00, provimi do të zgjasë 4 (katër) orë.**

Kandidatët janë të obliguar që të paraqiten për regjistrim jo më vonë se ora 08:00.

Kandidatët të cilët nuk paraqiten në orarin e sipër cekur ose paraqiten pasi që të gjithë kandidatët hynë në sallën e mbajtjes së Provimit të Jurisprudencës, nuk do të lejohen të marrin pjesë në provim.

**KANDIDATI ËSHTË I OBLIGUAR** që të marrë me vete dokumentin personal për identifikim (letërnjoftimin ose pasaportën). Nuk do të pranohet asnjë dokument tjetër.

**KANDIDATIT I LEJOHET** që në Provim të Jurisprudencës me shkrim, me vete të ketë vetëm: Legjislacionin përkatës në fuqi, lapsin kimik me ngjyrë të kaltër.

**KANDIDATIT NUK I LEJOHET** që të kenë në SALLË: asnjë lloj telefoni, kompjuteri, kamere, dëgjuese-kufje, aparat MP3 apo ndonjë pajisje tjetër elektronike të çfarëdo lloji.

**KANDIDATIT NUK I LEJOHET** që të kenë në posedim: asnjë lloj shënimi, materiali lexues apo material përshkrimi, forma të akteve gjyqësore dhe orë dore.

Shkelja e rregullave, nga ana e kandidatit rezulton me diskualifikimin e tij dhe shpalljen e provimit të pavlefshëm për të.

Vendi i mbajtjes së Provimit të Jurisprudencës me shkrim është **kampusi i ri i Universitetit “Isa Boletini”- Mitrovicë, Rr. Ukshin Kovaçica. 40000 Mitrovicë.**

**NJOFTIM**  
**PËR KOHËN E PAGESËS PËR PROVIM DHE RI-PROVIM TË JURISPRUDENCËS**

Njoftohen të gjithë kandidatët të cilët kanë aplikuar për dhënien e Provimit të Jurisprudencës për afatin e Maj 2023 dhe planifikoj që të hyn në provim me shkrim me datat 13 dhe 14 Maj 2023 si dhe ata që kanë mbetur ne Ri-provim me datën 14 Shkurt 2023, afati i pagesës do të jetë **VETËM ME DATËN 10.05.2023, DUKE FILLUAR NGA ORA 09:00.**

Fletëpagesa merret në Ministrinë e Drejtësisë, kati përdhese te Recepcioni i Ministrisë së Drejtësisë. Do të konsiderohet se është bërë pagesa vetëm atëherë kur kandidati e sjell fletëpagesën e vërtetuar nga Banka me datën 10.05.2023. Ne emër te kandidatit fletëpagesën mund ta merr, paguan dhe ta sjelle në Ministri edhe personi tjetër brenda afatit të përcaktuar për pagesë.